

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Këshilli Gjyqësor i Kosovës**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr1 i prokurimit	328-26-3412-5-1-1
Nr i brendshëm	

Sa i përket tenderit për: **Riparimi dhe mirëmbajta e objekteve të gjykatave dhe SKGJK-se**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

N.N.P. Pro Art

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

rr.Fatime Hetemi; nr.27

(Adresa)

Prishtinë

10000

(Vendi)

(Kodi postar)

+38344137277

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Hilmi Mulaku

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

contact@cmdsoftwares.com

(Adresa elektronike)

29.07.2026

(Data e parashtrimit të ankesës)



(Nënshkrimi dhe vula)

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për Kontratë: **26.05.2026**
Data e hapjes së ofertave: **25.06.2026**
Njoftimi mbi vendimin e AK-së: **16.07.2026**
Kërkesa për rishqyrtim dt:**20.07.2026**
Vendimi mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim dt:**22.07.2026**

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

Hapja elektronike në platformën e E-Prokurimit

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së
Neni 6 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 61 i LPP-së
Neni 64 i LPP-së
Neni 66 i LPP-së
Neni 69 i LPP-së
Neni 72 i LPP-së
Neni 25 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik
Neni 40, 41, 60, 64, i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik
Neni 10 i Udhëzuesit Nr.001/2023 për Prokurim Publik (me ndryshimet e 002/2024)

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Me publikimin e Njoftimit mbi Vendimin e AK-së – Formulari B58, të datës 16.07.2026, oferta e N.N.P. Pro Art & Rexha SH.P.K. është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit “Riparimi dhe mirëmbajtja e objekteve të gjykatave dhe SKGjK-së”, me numër 328-26-3412-5-1-1.

Duke konsideruar se eliminimi ynë është mbështetur në interpretim të gabuar të ofertës, ndërsa dokumentacioni i OE-së së rekomanduar nuk është vlerësuar sipas kërkesave të Dosjes së Tenderit, paraqesim këtë Kërkesë për Rishqyrtim dhe kërkojmë anulimin e vendimit dhe kthimin e aktivitetit në rivlerësim.

PIKA 1 – Eliminimi i pabazuar për shkak të shënimit “N/A”

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim: Tenderi i juaj është administrativisht i papërgjegjshëm:

ARSYETIM

Ju jeni diskualifikuar për këto arsye :

Në kuadër të procesit të vlerësimit të ofertave për aktivitetin e prokurimit “Riparimi dhe mirëmbajtja e objekteve të gjykatave dhe SKGjK-se”, komisioni i vlerësimit ka konstatuar se në disa pozicione në listën e çmimeve nuk është plotësuar Titulli i Prodhuesit dhe vendi i origjinës

Pasi lista e çmimeve duhet të plotësohet në tërësi dhe pa ndryshime në përmbajtje.

Rrjedhimisht, në përputhje me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik, Rregullore Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, Udhëzues 002/2024, për plotësim ndryshimin e udhezuesit Nr . 001/2023 për Prokurimin Publik. Pika 10. Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve

Lista e çmimeve nuk është Plotësuar Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm

Kusht administrativ - Oferta juaj është e papërgjegjshme

Çështja e kontestuar

AK ka eliminuar ofertën tonë me arsyetimin se në disa pozicione nuk janë plotësuar kolonat “Prodhuesi” dhe “Vendi i origjinës”. Ky konstatim nuk pasqyron përmbajtjen reale të ofertës, sepse këto kolona nuk janë lënë të paplotësuara, por janë shënuar me “N/A” vetëm në pozicionet që përbëjnë punë ose shërbime dhe për të cilat prodhuesi dhe vendi i origjinës objektivisht nuk aplikohen.

Për materialet dhe produktet e ofruara, OE ka deklaruar prodhuesin dhe vendin e origjinës. Ndërsa për aktivitetet si demolimi, largimi, pastrimi dhe punët e tjera të ngjashme, shënimi “N/A” përbën deklaram të qartë se këto të dhëna nuk janë të aplikueshme. Të gjitha çmimet, njësitë matëse dhe elementet që ndikojnë në përmbajtjen dhe vlerën e ofertës janë plotësuar.

Interpretimi i gabuar i kolonës “Prodhuesi”

Gjatë qasjes në dokumentacion, AK ka deklaruar se në kolonën “Prodhuesi” është dashur të shënohej operatori që ofron shërbimin. Mirëpo, kjo kolonë kërkon shprehimisht prodhuesin dhe jo ofruesin e shërbimit. Këto nocione nuk janë të njëjta dhe nuk mund të zëvendësohen përmes një interpretimi të dhënë pas hapjes së ofertave.

Nëse AK ka synuar që për pozicionet e shërbimeve të shënohej emri i ofruesit, kjo është dashur të përcaktohej qartë në Dosjen e Tenderit ose përmes një sqarimi të publikuar para afatit për ofertim. Një kërkesë e tillë nuk mund të krijohet dhe të zbatohet në mënyrë retroaktive gjatë vlerësimit.

Praktika e mëparshme e vetë AK-së

Në procedurën e mëparshme me objekt të njëjtë, nr. 328-24-6671-5-2-1, AK ka pranuar një ofertë në të cilën, për pozicionet e punëve dhe shërbimeve, në kolonat “Titulli i prodhuesit” dhe “Vendi i origjinës” ishte shënuar “N.A”.

Kjo ofertë është shpallur fituese dhe Lista e Çmimeve është përfshirë si pjesë përbërëse e kontratës së nënshkruar më 29.10.2024. Shënimi “N.A” ishte përdorur, ndër të tjera, për demolime, largime, gërmime, pastrime, matje dhe përgatitje raportesh. Në asnjërin prej këtyre pozicioneve AK nuk kishte kërkuar që në vend të prodhuesit të shënohej ofruesi i shërbimit.

Prandaj, interpretimi i përdorur në procedurën aktuale bie në kundërshtim të drejtpërdrejtë me praktikën e mëparshme të vetë AK-së për një kontratë me objekt dhe strukturë të njëjtë.

Vlerësimi juridik

Sipas parimeve të transparencës, trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit të përcaktuara në LPP, vlerësimi duhet të bëhet vetëm mbi bazën e kërkesave të shprehura qartë në Dosjen e Tenderit. AK nuk mund ta eliminojë një ofertë duke u bazuar në një interpretim ose kërkesë që nuk u është bërë e ditur paraprakisht operatorëve ekonomikë.

Edhe udhëzimet e KRPP-së kërkojnë që devijimet të vlerësohen rast pas rasti, duke shqyrtuar ndikimin e tyre real në përmbajtjen e ofertës. Në praktikën shqyrtuese të OSHP-së është konstatuar në raste të ngjashme se një OE nuk mund të eliminohet për mosplotësimin e një kërkesë që nuk ka qenë e përcaktuar qartë, si dhe se mangësitë pa ndikim në çmim, sasi ose përmbajtje thelbësore duhet të trajtohen si çështje formale apo të sqarueshme.

Në këtë rast, shënimi “N/A” nuk ndryshon ofertën, çmimin apo përgjegjësinë e OE-së dhe nuk krijon asnjë përparësi konkurruese. Edhe nëse AK ka pasur paqartësi rreth kuptimit të këtij shënimi, ka mundur të kërkojë sqarim në përputhje me nenin 72 të LPP-së, pa lejuar ndryshimin e ofertës.

Përfundimisht, eliminimi i OE Pro Art është i pabazuar dhe joproporcional. Kërkojmë që AK ta anulojë këtë arsyetim dhe ta kthejë ofertën tonë në rivlerësim, duke e trajtuar shënimin “N/A” sipas kuptimit të tij real dhe në përputhje me praktikën që vetë AK ka ndjekur më parë.

PIKA 2 – Mospërmbushja e kërkesës për minibager nga OE i rekomanduar

Gjithashtu ju sqarojme se ne baze të legjislacionit në fuqi për regjistrimin e mjeteve motorike me nr: LIGJI Nr. 05/L-132.

Ne përputhje me ligjin e lartcekur automjetet, mjetet e punës i nënshtrohen regjistrimit vetëm kur marrin pjesë në trafikun rrugor. Për rrjedhojë minibageri i prezantuar në dosje nga ana jone është mjet i cili bartet në rimorkio, ndërsa pronsia dhe identifikimi i mjetit deshmohet përmes DUD-it doganor ku janë të prezantuara të dhënat identifikuese.

Andaj mungesa e librezës nuk paraqet mungesë të dokumentacionit por është pasojë e natyrës juridike dhe teknike për këto lloje të mjeteve.

Shih foton se si bëhet transporti



Globalbuild SHPK



Arbëri-NS SHPK



Kërkesa e Dosjes së Tenderit

AK ka kërkuar së paku një minibager me peshë jo më të vogël se 3.5 ton. Si dëshmi dokumentare është kërkuar:

- fotografia dhe librezë e qarkullimit të minibagerit; ose
- kontrata për huazimin e një minibageri me kapacitetin e kërkuar, për shfrytëzim për kohë të pacaktuar.

Kjo kërkesë ka qenë e qartë dhe e detyrueshme për të gjithë operatorët ekonomikë.

Mungesa e dokumentit të kërkuar

Nga dokumentacioni i qasjes rezulton se OE i rekomanduar nuk e kishte dorëzuar librezën e qarkullimit. Këtë mungesë e ka konstatuar edhe vetë AK në kërkesën për sqarim, duke kërkuar shprehimisht dorëzimin e librezës për minibagerin me peshë jo më të vogël se 3.5 ton dhe duke paralajmëruar se mosdorëzimi do të rezultonte me refuzimin e tenderit.

Në përgjigje, OE nuk ka dorëzuar librezën, por ka deklaruar se minibageri bartet me rimorkio dhe, sipas tij, nuk i nënshtrohet regjistrimit. Ai është referuar në DUD-in doganor dhe ka paraqitur një fotografi të mënyrës së transportimit.

Kjo përgjigje e konfirmon se dokumenti i kërkuar nga AK nuk ekziston dhe nuk është dorëzuar. Fotografia e transportimit nuk dëshmon regjistrimin, pronësinë, të dhënat teknike apo peshën minimale prej 3.5 tonësh. Po ashtu, DUD-i doganor nuk është dokumenti i kërkuar në Dosjen e Tenderit dhe nuk mund të trajtohet si zëvendësim i librezës së qarkullimit.

Pamundësia e sanimit përmes sqarimit

Neni 72 i LPP-së lejon sqarimin e dokumenteve ose informatave ekzistuese, por jo zëvendësimin e një dëshmie të kërkuar me një dokument tjetër dhe as plotësimin pas afatit të një kriteri që nuk ishte dëshmuar në ofertën fillestare.

Në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me një paqartësi formale. Vetë OE ka pranuar se minibageri nuk posedon librezë qarkullimi. Prandaj, përmes sqarimit nuk mund të krijohet një gjendje e re që do ta shndërronte ofertën fillimisht të papërgjegjshme në ofertë të përgjegjshme.

Në praktikën shqyrtuese të OSHP-së, në raste të ngjashme është konstatuar se mungesa e dëshmisë së përcaktuar qartë për kapacitetin teknik nuk mund të zëvendësohet pas afatit me deklarata, fotografi ose dokumente të një natyre tjetër. Po ashtu, nëse një OE ka konsideruar se kërkesa për librezën ishte e papërshtatshme për këtë lloj makinerie, këtë është dashur ta kundërshtonte ose të kërkonte sqarim para dorëzimit të ofertave.

Përfundimisht, OE i rekomanduar nuk e ka dëshmuar posedimin ose shfrytëzimin e minibagerit në mënyrën e kërkuar nga Dosja e Tenderit. Pranimi i një fotografie, DUD-i apo shpjegimi të mëvonshëm në vend të librezës përbën ndryshim të kërkesës pas hapjes së ofertave dhe trajtim të pabarabartë. Për këtë arsye, oferta e OE të rekomanduar duhet të shpallet e papërgjegjshme dhe vendimi i AK-së të anulohet.

PIKA 3 – Certifikata e TVSH-së e regjistruar pas afatit për ofertim

ATK - TAK - PAK ATK - TAK - PAK

CERTIFIKATË - DEKLARUES I TVSH
UVERENJE - OBVEZNIK ZA PDV
CERTIFICATE - VAT FILER K - TAK - PAK

Numri
Broj
Number
330702036

Numri Fiscal
Fiskalni Broj
Fiscal Number
812424349

Emri i personit
Ime osebe
Person's Name
GlobalBuild SH.P.K.

Adresa e Personit
Adresa osebe
Person's Address
REXHEP LUCI, 16, Katë 2, Nr. 1 PRISHTINË PRISHTINË KOSOVA

Data e Regjistrimit
Datum Registracije
Registration Date
01-07-2026

Data e Lëshimit
Datum Izdavanja
Date of Issuance
01-07-2026

Personi Përgjegjës
Odgovorno Lice
Responsible Person

Kjo certifikatë është Miratuar nga Administrata Tatimore e Kosovës, bazuar në Ligjin Nr. 05L-037 për Tatimin në Vlerën e Shtuar.
Ovaj certifikat izdat je od Poreske Administracije Kosova, shodno Zakonu Br. 05L-037 O Porezu na Dodanu Vrednost.
This certificate is issued by the Tax Administration of Kosovo, based on the Law Nr. 05L-037 on Value Added Tax.

ATK - TAK - PAK ATK - TAK - PAK

Kronologjia e fakteve

Sipas Formularit B54, afati për dorëzimin dhe hapjen e ofertave ka qenë më **25.06.2026, në orën 14:00**. Në këtë moment, çdo operator ekonomik është dashur t'i përmbushte kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit, përfshirë kërkesën:

“Regjistrimi i TVSH-së – Kopja e certifikatës së TVSH-së.”

Nga dokumentacioni i qasjes rezulton se OE lider “GlobalBuild” SH.P.K. nuk e kishte dorëzuar certifikatën e TVSH-së me ofertën. Për këtë arsye, AK ka kërkuar plotësimin e saj përmes kërkesës për sqarim.

Certifikata e dorëzuar më pas tregon se data e regjistrimit në TVSH dhe data e lëshimit të certifikatës janë **01.07.2026**, pra gjashtë ditë pas përfundimit të afatit për dorëzimin e ofertave.

Kriteri nuk ekzistonte në datën e ofertimit

Nuk kemi të bëjmë me dorëzimin e vonuar të një dokumenti që ka ekzistuar para afatit. Vetë regjistrimi në TVSH është bërë pas datës 25.06.2026. Kjo do të thotë se, në momentin e dorëzimit të ofertës, OE lider nuk e përmbushte kriterin e kërkuar.

Përmes sqarimit mund të dëshmohet një gjendje që ka ekzistuar para afatit, por nuk mund të fitohet një status i ri juridik pas hapjes së ofertave dhe ai të zbatohet në mënyrë retroaktive. Pranimi i certifikatës së datës 01.07.2026 do të nënkuptonte lejimin e plotësimit të një kriteri të përshtatshmërisë pas afatit për ofertim.

Edhe vetë AK, në kërkesën për sqarim, kishte deklaruar se mosdorëzimi i certifikatës do të rezultonte me refuzimin e tenderit. Megjithatë, dokumenti i dorëzuar nuk vërteton se kërkesa plotësohet në datën e ofertimit, por dëshmon të kundërtën.

Vlerësimi juridik

Neni 72 i LPP-së nuk lejon që përmes sqarimit një operator ekonomik të fitojë pas afatit një kualifikim ose status që nuk e kishte në momentin e ofertimit. Në praktikën shqyrtuese të OSHP-së, në raste të ngjashme është konstatuar se dokumentet e dorëzuara pas afatit mund të shërbejnë vetëm për të konfirmuar fakte ekzistuese, por jo për të krijuar kapacitet ose përshtatshmëri të re.

Pranimi i kësaj certifikate cenon gjithashtu trajtimin e barabartë, sepse OE të tjerë kanë qenë të detyruar t'i përmbushnin kërkesat deri më 25.06.2026, ndërsa OE të rekomanduar i është mundësuar që kriterin ta plotësojë pas hapjes së ofertave.

Përfundimisht, certifikata e TVSH-së e regjistruar dhe lëshuar më 01.07.2026 nuk mund ta bëjë ofertën retroaktivisht të përgjegjshme. OE i rekomanduar nuk e ka përmbushur këtë kërkesë në momentin relevant, prandaj oferta e tij duhet të shpallet e papërgjegjshme dhe vendimi i AK-së të anulohet.

Duke u bazuar në të gjitha faktet dhe dëshmitë që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP-ja që të merr:

VENDIM

I. PRANOHET NË TËRËSI, si e bazuar, Ankesa e Operatorit Ekonomik N.N.P. **“Pro Art & Rexha Sh.P.K.”**, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Riparimi dhe mirëmbajta e objekteve të gjykatave dhe SKGjK-së”, me nr. të prokurimit **328-26-3412-5-1-1** dhe nr. të brendshëm **33300/026/009/511**, të zhvilluar nga Autoriteti Kontraktues **Këshilli Gjyqësor i Kosovës**.

II. SHFUQIZOHET Njoftimi mbi Vendimin dhe letrat standarde të datës **16.07.2026**, në pjesën që ka të bëjë me eliminimin e ofertës së OE N.N.P. **“Pro Art & Rexha Sh.P.K.”** dhe rekomandimin për kontratë të Grupit të Operatorëve Ekonomikë **GlobalBuild SH.P.K. & ARBËRI-NS SH.P.K.**

III. KTHEHET aktiviteti i prokurimit në rivlerësim, me detyrimin që AK ta trajtojë shënimin “N/A” në përputhje me natyrën e pozicioneve të shërbimeve, si dhe të verifikojë përmbushjen nga grupi i rekomanduar të kërkesave për minibagerin dhe regjistrimin në TVSH brenda afatit për ofertim.

IV. DETYROHET AK që rivlerësimin ta zhvillojë mbi bazën e kërkesave të përcaktuara në Dosjen e Tenderit, dispozitave të LPP-së dhe parimeve të transparencës, proporcionalitetit, trajtimit të barabartë dhe konkurrencës së drejtë.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet materiale dhe fitimi i humbur do të përcaktohen dhe kalkuloohen në një fazë të mëvonshme, në varësi të zhvillimit dhe rezultatit të kësaj procedure.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- c) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*
- d) B58 Njoftim mbi vendimin e AK*
- e) Dokumente nga qasja ne dokumentacion*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*

